Numër:01/274
Datë: 19.05.2023

Në mbështetje të nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-189, nenit 6 dhe 16 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë nr. 35/2014, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 03.05.2023 nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **Riakreditohet** Qendra Regjionale e Aftësimit Profesional – Pejë, Fidanishte Rr. "Kasim Shala" Pejë, Kosovë, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 30.09.2022 deri 29.09.2025, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

   1.1 **Prodhuesit e produkteteve të qumështit, Niveli III sipas KKK,** lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 15 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit për një vit kalendarik në total 3 grupe brenda vitit. Ndërsa numri i kandidatëve për 1 grup mund të jetë maksimalisht 8 deri 10 kandidatë, për një cikël trajnimi.

2. **Akreditohet** Qendra Regjionale e Aftësimit Profesional Pejë, Fidanishte Rr. "Kasim Shala" Pejë, Kosovë, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 03.03.2023 deri 02.03.2026, me kualifikimet e aprovuara në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

   2.1 **Menaxher i ndërmarrjeve mikro dhe të vogla, Niveli III sipas KKK,** lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 12 kredi të APP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit, për një vit kalendarik, qendra mund të trajnoj në total 4 grupe. Ndërsa numri i kandidatëve për 1 grup mund të jetë maksimalisht 7 kandidatë.
   2.2 **Nëpunës i kontabilitetit, Niveli IV sipas KKK,** lloji: Kualifikim Kombëtar Profesional (D) me 15 kredi të APP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit, për një vit kalendarik, qendra mund të trajnoj në total 3 grupe. Ndërsa numri i kandidatëve për 1 grup mund të jetë maksimalisht 10 kandidatë.

3. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së "Kolegji Biznesi SH.P.K. Prishtinë, për akreditim dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve mbi validimin e kualifikimit, si dhe Raporti i ekipit të ekspertëve mbi akreditimin e institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Kolegjit Biznesi SH.P.K.;
2. Arkivit të AKK.

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK